



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2022:072735

Datë: 04.09.2024

Numri i dokumentit: 06119083

C.nr.1243/2022

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Taulant Rexhëbeqaj, në çështjen juridike kontestimore të paditësve A.H. dhe E.A. që të dyja nga Prizreni, të cilat me autorizim i përfaqëson “Avokatura” SH.P.K, të cilën e përfaqësojnë A.I., Z.I., A.K., J.I. dhe B.D. të gjithë avokat nga Prishtina, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “Scardian” me seli në Prishtinë, me objekt kontesti kompensim dëmi, jashtë seance, më datën 04.09.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. KONSTATOHET** e tërhequr padia me numër C.nr.1243/2022, e paditësve A.H. dhe E.A. që të dyja nga Prizreni, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “Scardian” me seli në Prishtinë, në këtë çështje juridike kontestimore.
- II.** Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Në Gjykatën Themelore në Prizren, është inicuar procedura civile sipas padisë së paditësve A.H. dhe E.A. që të dyja nga Prizreni, të cilat me autorizim i përfaqëson “Avokatura Istrefi” SH.P.K, të cilën e përfaqësojnë A.I., Z.I., A.K., J.I. dhe B.D. kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “Scardian” me seli në Prishtinë, me objekt kontesti kompensim dëmi.

Me parashtrësën e datës 14.08.2024, i autorizuari i paditësve e ka njoftuar gjykatën se e tërheq padinë, me arsyetimin se me të paditurën kanë arritur pajtim jashtëgjyqësor.

Gjykata me njoftimin C.nr. 1243/2022, të datës 16.08.2024, e ka ftuar të paditurën, që në afat prej 7 ditësh nga pranimi i këtij njoftimi të deklarohet lidhur me veprimin procedural të palës paditëse për tërheqjen e padisë. E paditura njoftimin në fjalë e ka pranuar me datën

23.08.2024, e cila konstatohet nga fletë kthesa e cila gjendet në shkresat e kësaj lënde, ndërsa e njëjta nuk është deklaruar për tërheqjen e padisë.

Andaj, bazuar në nenin 261 par. 1 të LPK-së, ku parashihet se “*Paditësi mund ta tërheqë padinë pa pëlqimin e të paditurit deri në momentin në të cilin i padituri e paraqet në gjykatë përgjigjen në padi*”, ndërsa në par.2 të po këtij neni thuhet se “*Padia mund të tërhiqet edhe më vonë, deri në përfundimin e shqyrtimit kryesor, në qoftë se i padituri e jep pëlqimin për një gjë të tillë. Po që se i padituri brenda shtatë (7) ditësh nga dita e njoftimit për tërheqjen e padisë nuk deklarohet për këtë gjë, do të konsiderohet se e ka dhënë pëlqimin për tërheqjen e padisë*”, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Lidhur me shpenzimet e procedurës gjykata ka vendosur në kuptim të nenit 450 të LPK-së.

Gjykata në kuptim të dispozitave nga neni 261 par.2 e lidhur me nenin 387.1 pika c, të Ligjit për Procedurën Kontestimore, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil
C.nr.1243/2022, të datës 04.09.2024

G j y q t a r i

Taulant Rexhëbeqaj

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa, bazuar në nenin 261.4 të LPK-së.